



## **KOMUNIKATË**

**5.03.2010**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e fundit të udhëhequr nga kryetarja znj. Nesrin Lushta, miratoi rendin e ditës dhe raportet nr. 02, nr. 20, nr. 21 dhe nr. 22/ 2010. Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, e informoi KQZ-në me aktivitetet e fundit të Sekretariatit. Z. Peqani, tha se janë bërë specifikat për fletëvotimet dhe Listën përfundimtare të votuesëve dhe tërë materialin zgjedhor të domosdoshëm për Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Istog. Është duke u bërë drafti i Planit Operacional dhe i shpenzimeve për komunën e Istogut dhe të Parteshit, si dhe buxheti shtesë që do të kërkohet për këto zgjedhje. Trajnimet e KVV-ve për komunën e Gjilanit janë duke vazhduar sipas planit. Ende janë duke vazhduar pagesat e KVV-ve të stafit teknik të angazhuar në zgjedhjet e përsëritura të Raundit të Dytë të Kryetarëve të Komunave në Lipjan dhe Prizren, dhe ky aft është deri më 15 prill.

Kryeshefi Xhemajl Peqani, e ka thënë se, kanë filluar takimet e sigurisë me Policinë e Kosovës, KFOR-in, Policinë e ELEX-it dhe OSBE-në lidhur me koordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me planin e sigurisë. Takime do të mbahen ç`do të enjte, deri në përfundimin e zgjedhjeve në komunën e Parteshit. Është dërguar një ekip i SKQZ-së në Slloveni, i cili do të monitorojë procesin e prodhimit dhe të shtypjes së fletëvotimeve për përsëritjen e Raundit të Dytë të Zgjedhjeve në komunën e Gjilanit. Prodhimi i këtyre fletëvotimeve, do të filloj më 05.03.2010.

Në bazë të procedurave të OVPP-se janë dërguar pakot e fletëvotimeve të të gjithë aplikantëve të cilët gjenden në listën e Votimit me Postë. Numri i të regjistruarve në VP në komunë e Gjilanit, përfshinë 107 aplikantë. Numri i aplikantve në komunë e Istogut përfshinë 74 aplikant. Është bërë shpallja e konkursit për zyrtar të lartë të Logjistikës dhe për zyrtarë i lartë komunal zgjedhor për Partesh dhe Kaçanik. Së bashku me IFES-in, është duke u përgatitur aktiviteti i QNR-së rreth zgjedhjeve në Gjilan, Istog dhe Partesh. Është bërë konfirmimi dhe identifikimi i Qendrave të Votimit, të Vendvotimet dhe numri i votuesve për komunën e Parteshit.

Betim Gjoshi, anëtar i KQZ-së e informoi KQZ-së lidhur me aktivitetet e Këshillit Operacional të Zgjedhjeve. Në mbledhjen e Këshillit, është shqyrtuar plani Operacional i Zgjedhjeve të 11 prillit për komunën e Istogut. Këshilli i rekomandon KQZ-së që ky plan të aprovohet. Gjithashtu, është shqyrtuar edhe ligji lidhur me asgjësimin e materialit zgjedhor, i cili mund të asgjësohet 60 ditë pas zgjedhjeve. Në prezencë të KQZ-së materiali do të asgjësohet pas rivotimit në Gjilan. Për këtë, duhet të informohet edhe Prokuroria e shtetit, e cila duhet të vërtetojë nëse ka edhe ndonjë çështje rreth zgjedhjeve që duhet të shqyrtohet dhe pastaj, KQZ mund ta asgjësoj e materialit. Sipas ligjit, KQZ

vendos se si do të bëhet asgjësimi i materialit. KQZ e miratoi Planin Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Istog, dhe asgjësimin e materialeve e të zgjedhjeve Lokale 2009.

Në vazhdim të mbledhjes Zyra Ligjore, i rekomandoi KQZ-së zëvendësimin e Këshilltarëve Komunal. KQZ miratoi zëvendësimin e një (1) Këshilltari për komunën e Obiliqit, të një (1) Këshilltari për komunën e Suharekës, të një (1) Këshilltari për komunën e Mitrovicës dhe pesë (5) Këshilltarë për komunën e Podujevës.

Këshilli për Buxhet dhe Prokurim, i ka rekomanduar KQZ-së miratimin e shpenzimeve të buxhetit për muajin nëntor 2009. KQZ e ka miratuar këtë rekomandim. Blerim Burjani, anëtar i këtij këshilli, e ka informuar KQZ-në për planin buxhetor të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Istog që do të mbahen me 11 prill dhe, për zgjedhjet e rregullta në Partesh që do të mbahen më 20 qershor. Plani buxhetor për këto dy komuna, përfshinë një shifër prej 490185 euro. KQZ e ka miratuar buxhetin për këto dy komuna.